

Entela Tabaku Sörman - Poezi (2)

Contributed by jozef martini
Tuesday, 15 July 2014

Poezi (2)

Entela Tabaku Sörman

POEZI (2)

Entela Tabaku Sörman

hana ma din emnin mirë

netët me hanë janë ma të vështirat

hana ma din emnin mirë

e më thërret

(ku shkove moj vajzë

ku humbe

(ku mbete(

hajde(

kur po vjen bijë

mos e shif hanën

(më thoshte nanababe

e m'i mbyllte perdet

mos e ndigjo natën

(e më strukte në prehën

nuk vijnë(

nuk vijnë

nuk vijnë(
 as nanababe as nanadaje
 as gjyshi Lec as gjyshi Musa
 as axha as halla(
 as baba
 (ata nuk vijnë(
 ma

as unë nuk vij(
 unë vetëm shkoj(
 në netët me hanë(
 kur këtu tanë kanë fjetë

unë shkoj(
 pse hana jeme
 flet shqip

fëmijët e emigrantëve

fëmijët e emigrantëve janë fëmijët për të cilët
 gjyshja asht ajo fytyra e qeshun në skype(
 ajo grueja e ngrohtë që i shtrëngon fort(
 e nuk din me i lëshu
 në verë
 (që bajnë tre ditë me u mësu(
 mandej vjen koha me ikë
 (e një vit rrijnë duke e andrru
 (fëmijët e emigrantëve nuk e dinë(
 se gjyshja asht një prehën i ngrohtë
 (ku ti mundesh me u fshehë çdo ditë(
 asht ajo që t'i fal tana pa kushte
 (që të del zot kur nana asht nevrrik(
 asht një bohçe me xhepa mbushë me gjana të mira për ty
 asht zani që të pajton
 (me kangë të vjetra që ti s'i kupton(
 por që të kujtohen papritmas një ditë(
 kur bjen shi e ai që don ka ikë
 (asht plaka që ta ban nanën të re(
 e të difton se jeta asht e bukur
 (se kështu ka kenë(
 se kështu ka me kenë(
 e se ia vlen(
 tanë shiu i botës ia vlen
 (fëmijët e emigrantëve
 (të mirët e mij

ka nisë me iu trashë zani djalit tem

ka nisë me iu trashë zani djalit tem
 (më trembi tash nade kur më tha "si ke nje?"
 tanë trupin e ka dëshirë për me u rritë
 me ikë(
 me mbërritë

si arka e Noes(
 po bahet gati me u lëshu(
 ma

në ujërat e trazuem të adoleshencës
e kushedi sa vite ka me zgjatë
(derisa të takojë në tokë(
prapë

unë s'mundem me u nisë me të(
veç ia kam qëndisë një degë ullinit në jastek
e lutem t'ia kem mbushë mirë arkën
(sa kohë e pata(
djep

ka disa vite që po pres

ka disa vite që po pres(
atë që gratë në moshën teme gjithmonë kanë thanë
po pres me u plakë

mos ne shqiptaret e kena në gen me u plakë shpejt?
se këtu as plakat nuk plaken(
ne e lëshojmë vedin herët(
nisim me thanë "u plaka"
"u plake"(
sapo fëmijët na rriten pak
në fillim jena vajza
mandej bahena plaka

pse e plakim njena-tjetrën
(brez mbas brezi(
gra?(
shtyjmë vedin e tjerat me luejtë rolin e plakës
ejani gra të luejmë plakash
plaka të nderueme
harrojmë vedin
(jetojmë veç për të tjerët
"dukesh si vajzë e re" i bajmë kompliment
ndonjenes që nuk hyn në rol(
asaj që duket si një që i ka katërdhjetë
pesëdhjetë vjet
e bukur dhe e fortë
a thue me mendjen e burrave kena mendu
gra?(
se burrave i pëlqejnë vajzat e reja(
e veç të rejave munden me ia dalë
ne i dimë mirë
(mos ndoshta na kanë plakë
se plakat nuk dijnë asgja

ejani të mos plakena
gra

fjalë gjypnerësh

i kam punu fjalët me gjypnerë(
tanë natën
(një gojë mbarë një gojë mbrapsht
mandej dy mbarë dy mbrapsht
(një rresht mbarë një rresht mbrapsht
mandej dy mbarë dy mbrapsht
(por tash nade po e shof(

se nuk kam çfarë me thanë(
 më kanë ikë gojë(
 kam ngatërru rreshtat
 (lamsh e paskam ba lamshin
 (e më vjen keq që s'e kam një micë
 lasticë(
 me ia hedhë lamshin me lujtë(
 me e pa tuj e gërگا me kambë(
 tuj e shpuplisë
 (tuj e hedhë
 (e harru nën divan

e më vjen keq që nuk jam micë

tanë dojnë me e ndryshu botën

tanë dojnë me e ndryshu botën
 tanë(
 në këtë botë(
 zemrat nuk kanë rehati

disa pse e kanë zemrën e gjanë(
 janë lindë me u ba njerëz të mëdhenj
 të lumtun nuk munden me kenë
 (kur të tjerët s'janë mirë

disa pse zemrën e kanë të vogël(
 ndërsa kujtojnë se janë njerëz të mëdhenj
 paqë nuk munden me gjetë(
 në një botë që u dha tjerëve(
 atë çka ata e deshtën për vedi

disa pse nuk kanë zemër hiç
 botën dojnë me e vra
 (pse tjerët
 janë

disa pse kanë veç zemër
 e vuetjje
 (jetojnë me gjak jashtë
 zemërkuq
 zemërblu
 zemërbardhë
 zemërzi(
 e bota asht bojëqiell

tanë dojnë me e ndryshu botën
 por unë jam njeri i thjeshtë
 botën e kisha ndryshu
 (ti me fjetë patrazuem
 në krahët e mij
 zemrës teme ia ka marrë masat
 kjo dashuri

mendimi për ty me një tjetër

mendimi për ty me një tjetër asht llavë e nxehtë
 nxehtë e nxehtë shtyhet e shkrehet nën shkambinj
 shkambinj e shkambinj të përpiqen me i qëndru kot

kot e kot me logjikë fort e plot rrjedhës
 rrjedhës e rrjedha përvëlueshëm e pandalshëm e ngeshëm
 ngeshëm e ngeshme i sulmon e i shkretton e i shemb e i shkrin
 shkrin krejt i shkrin e i zhan e i zhduk e i shkretton
 (shkretton oh si i shkretton e i shkruan e i shuen e i humb
 humb e përhumbe e gjithkund vetëm hi
 hi e hini ftohet e ngurtësohet e bahet shkamb
 shkamb(
 shkamb në mue asht mendimi për ty me një tjetër

unë di

unë di(
 unë di me pritë(
 unë di me pritë mirë
 unë di me pritë mirë e gjatë
 unë di me pritë mirë e gjatë përnatë(
 unë di me pritë mirë e gjatë përnatë kukuvajkë
 unë di me pritë mirë e gjatë përnatë kukuvajkë pa za
 unë di me pritë mirë e gjatë përnatë kukuvajkë pa za mbërthy
 unë di me pritë mirë e gjatë përnatë kukuvajkë pa za mbërthy fort
 unë di me pritë mirë e gjatë përnatë kukuvajkë pa za mbërthy fort për vedi

ty s'di me të pritë
 ty të du
 (fill

rrëfimi i pasqyrës

ti m'i thue fjalët çdo natë
 (të pëlqen me i ndie si tingëllojnë
 si ngjajnë(
 unë t'i kthej ma të bukura
 (ma të vërteta
 (të ngrohuna(
 për buzëqeshjen tande në mue
 a ndoshta vetëm në ty(
 a ndoshta vetëm në mue

ti harron se kajherë(
 mbas mejet rrin një shpirt i përdëlluem
 a ndoshta i vetmuem
 (a ndoshta i trishtuem
 (që kujton se ti ia shef sytë(
 e fjalët t'i thith
 (si të ishin për të(
 e në ta andrron
 (të pret

çuditësh mandej pse të thehem
 ndër buzë
 (ti butë pra(
 sa butë më puth

një si

I.(
një si sëmbim
shpim(
therje(
ma shumë si tkurrje
rrëgjim(
pakim
(bllokim gjaku
(në zemër
(por edhe si gërryemje
gërrdhishtje
(diçka me grrr(
mandej si gjeth
gjethim(
që e han krymbi(
grrc grrc grrc(
një si kafshim
shtrëngim

ma thuej një fjalë

II.(
një si ngërç
kramp(
pisk(
ndoshta krisje
çamje
(thymje(
mbas qafet(
por edhe si e zanun keq
në leq
për dreq
(diçka me eqqqq(
veq(
a ndoshta eççççç(
veç e veç(
veçan
(veçse ma thuej një fjalë
të përveçme
ose
zemër

Prej arkivit te Albanovaonline:

Entela Tabaku Sörman, Poezi (1)

